**KËRKESË**
**Nr. 98, datë 18.1.2022**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtim kopshti dhe çerdhe e integruar nr. 42”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit ‘ndërtesë banimi ose jobanimi’”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 66 620 761.20 (gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një pikë njëzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
**Erlis Hereni**

LISTA PARAPRAKE

E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "NDËRTIM KOPSHTI DHE ÇERDHE E INTEGRUAR NR. 42"

| **Nr.** | **Pronari** | | | **Të dhëna hipotekore** | | | | | | | | | **Vlerësimet për shpronësim** | | | | | | | **Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë)** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | **Truall** | | | **Ndërtesë** | | | **Vlera totale (lek)** | |
| | **Emri** | **Atësia** | **Mbiemri** | **Fshati ose qyteti** | **Zona kadastrale** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pasurisë** | **Sipërfaqja totale** | **Truall ($m^2$)** | **Ndërtesë ($m^2$)** | **Volumi** | **Faqe** | **Sipërfaqja ($m^2$)** | **Çmimi (lek/$m^2$)** | **Vlera (lek)** | **Sipërfaqja ($m^2$)** | **Çmimi (lek/$m^2$)** | **Vlera (lek)** | | |
| 1 | Jorgo Petraq | Gaqo Gaqo | Papadhopuli Papadhopulli | Tiranë | 8270 | 2/899 | Truall | 657.5 | 657.5 | - | 93 | 107 | 657.5 | 66969 | 44,032,117.50 | - | - | - | 44,032,117.50 | |
| 2 | David Mark | Bashkim - | Haxhi Shantoja | Tiranë | 8270 | 2/427 | Truall | 337.3 | 337.3 | - | 24 | 157 | 337.3 | 66969 | 22,588,643.70 | - | - | - | 22,588,643.70 | |
| 3 | Bashkia Tiranë | | | Tiranë | 8270 | 2/269 | Truall | 929 | 929 | 401.34 | 54 | 233 | 929 | 0 | 0 | 401.34 | 0 | 0 | 0 | Kopshti nr. 42. |
| 4 | Shtet | | | Tiranë | 8270 | 2/900 | Truall | 58 | 58 | - | 93 | 108 | 58 | 0.00 | 0 | - | - | - | 0 | |
| | **Total** | | | | | | | | | | | | **1981.8** | | | **401.34** | | | **66,620,761.20** | |

1. **Për tokën truall çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.**
2. **Llogaritjet paraprake të pasurive të kësaj liste, janë bazuar në shkresën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresën nr. prot. 3880/1, datë 14.4.2021.**